



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

RAPORT MONITORIMI

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

PERMBLEDHËSE

(JANAR – PRILL 2021)

Monitorimi i buxhetit të 4 mujorit të parë të vitit 2021 është procesi i vlerësimit të performancës, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me treguesit e planifikuar dhe ka për qëllim:

- ❖ Të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- ❖ Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- ❖ Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në institucionet arsimore të varësisë, sipas legjisllacionit në fuqi.
- ❖ Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucionet publike në juridiksionin e saj të kryhen në përputhje me legjisllacionin në fuqi.
- ❖ Të vlerësojë nëpërmjet ZAVP-ve, kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe të shqyrtojë për përmbushjen e kriterëve infrastrukturore për hapjen e institucioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.
- ❖ Të sigurojë zbatimin e kurrikulës, metodologjitë dhe standardet që mbështesin dhe përmirësojnë procesin e ofrimit të shërbimit arsimor.
- ❖ Të ofrojë ekspertizë teknike në hartimin e metodologjive mësimore, praktikave dhe teknikave që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.
- ❖ Të menaxhoj dhe mbikëqyr/kontrollon institucionet arsimore parauniversitare lidhur me zhvillimin e veprimtarive mësimore.
- ❖ Të monitorojë kualifikimet e personelit mësimdhënës për kurrikulën, metodologjitë dhe standardet e përcaktuara nga institucioni përgjegjës.
- ❖ Të menaxhojë me përgjegjësi rekrutimin e mësuesve nëpërmjet menaxhimit, mirëmbajtjes, përditësimit të portalit kombëtar “Mësues për Shqipërinë”, ndjekjen e procedurave përkatëse të konkurrimit, përpunimit e analizimit e të dhënave dhe shpalljen e rezultateve.
- ❖ Të organizojnë dhe mbështesin shërbimin psikosocial në institucionet arsimore publike.
- ❖ Të garantoj mirë administrimin e burimeve financiare dhe alokimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore bazuar në formulën “për nxënës”.
- ❖ Të bashkëpunojë me njësitë e vetëqeverisjes vendore për planifikimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve arsimore.
- ❖ Të monitorojë procedurat për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.
- ❖ Të organizoj dhe mbështes zhvillimin e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin parauniversitar.
- ❖ Të inspektojnë, monitorojnë, vlerësojnë, rekomandojnë dhe nxjerrin përfundime mbi zbatueshmërinë e kriterëve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private.
- ❖ Të mbledh dhe përpunoj të dhënat statistikore nga institucionet arsimore në juridiksionin e tyre.

- ❖ Të krijojë një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe eficient të MFK-së konform standardet ligjore, nëpërmjet menaxhimit me bazë performance. Eficenca në përdorim e burimeve financiare e materiale në arsim; efektiviteti në përdorimin e burimeve njerëzore: rritja e kapaciteteve e aftësive menaxhuese në nivelin rajonal (DAR/ ZA), lokal (institucionet arsimore)
- ❖ Të vendos mekanizma transparente të monitorimit të përdorimit të fondeve buxhetore në zbatim të akteve ligjore e nënligjore të sistemit arsimor në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ❖ Të rrisë dhe zhvillojë kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës dhe 12 ZVAP-e në juridiksion të saj kanë filluar aktivitetin më 20.05.2019, bazuar në VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”* dhe në Urdhërin të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr 234, datë 19.04.2019 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”*

Buxheti i DRAP Durrës dhe 12.ZVA-et në juridiksion është mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe në fondet buxhetore të alokuara për vitin 2021 dhe të rishikuar gjatë vitit 2021, si dhe në prioritetet e përcaktuara në programin e qeverisë, i cili ndahet në tre programe si më poshtë:

- ❖ **01110 - Planifikim menaxhim**
- ❖ **09120 - Arsimi Bazë**
- ❖ **09320 - Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)**
- ❖

Monitorimi i buxhetit të 4-mujorit të parë të vitit 2021 është realizuar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, të ligjit nr. 137/2020, datë 16.12.2020 *“Për buxhetin e vitit 2021”*, të ligjit nr. 10296 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”*, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”*.


DRAP Durrës dhe 12 ZVA-et në juridiksion të saj është përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe kryen disa detyra të përcaktuara një ndër to është *“Garantimi i miradministrimit të burimeve financiare dhe alokimit të tyre, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore”*.

Për të përmbushur detyrat ne kemi bërë parashikimet e nevojshme buxhetore, kemi hartuar projekt-buxhetin afatmesëm 2021-2023 sipas nevojave të institucionit dërguar dhe në MASR.

Në vijim po ju paraqesim fondet e akorduara dhe realizimet e shpenzimeve buxhetore në total dhe për cdo program buxhetor, sipas produkteve dhe llogarive ekonomike.


1.1 -Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore për 4-mujorin e parë 2021 ndaj planit të alokuar në vitin 2021

		Plani 4-mujor		Fakti 4-mujor	
		Në (000) Lekë	Në (%) ndaj buxhetit vjetor	Në (000) Lekë	Në (%) ndaj buxhetit vjetor
1110	Planifikim Menaxhim	42,791	1%	40,569	95%
9120	Arsimi Bazë	2,853,309	76%	2,744,437	96%
9230	Arsimi i Mesëm	854,637	23%	836,996	98%
	TOTALI	3,750,736	100%	3,621.955	100%




1.2 - Plani buxhetore në % për 4 mujorin e parë vitin 2021 sipas artikujve

DRAP Durrës +12 ZVAP-e në juridiksion		Plani 4-mujor I pare për vitin 2021 total sipas artikujve 000/lekë
Paga	600	3,129,642
Sigurime	601	527,257
Shpenz operative	602	84,536
Sub+fond I vecante	606	4,850
Investime	231	4,450
	TOTALI	3,750,736



1.3 Fondet e përdorura për 4-mujorin e parë 2021 sipas artikujve në të gjithë programet për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et në juridiksion.


Fakti shpenzimeve për 4-mujorin e pare 2021 000/lekë		
Paga	600	3,046,105
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	601	522,258
Shpenz operative	602	51,380
Sub+fond I vecante	606	2,212
	TOTALI	3,621.955



1.4 Plani ne % që zë cdo ZVAP ndaj planit total per DRAP +12 ZVAP –et ne juridiksion për vitin 2021

DRAP Durrës	Fakti I DRAP+12 ZVAP-e për periudhën e 4-mujorit të parë të vitit 2021 000/lekë
DRAP Durrës	4,978
ZVAP Krujë	208,596
ZVAP Bulqizë	123,872
ZVAP Tiranë	1,584,915
ZVAP Rrogozhinë	85,213
ZVAP Kavajë	142,164
ZVAP Durrës	526,303
ZVAP Mat	117,223
ZVAP Vorë	104,251
ZVAP Kamëz	311,933
ZVAP Shijak	75,054
ZVAP Dibër	259,521
ZVAP Klos	77,932
TOTALI	3,621,955

Fakti I DRAP+12 ZVAP-e për periudhën e 4-mujorit të parë të vitit 2021



- **Planifikim Menaxhim** – Fondet e rishikuara buxhetore janë **42.765** (Dyzetë e dy mijë e shtatëqindë e gjashtëdhjetë e pesë) 000/lekë, ose **1.1 %** të buxhetit total.
- **Arsimi Bazë** – Fondet e rishikuara buxhetore janë 2.853.309 (Dymilion e tetëqindë e pesëdhjetë e tre mije treqindë e nentë) 000/lekë, ose **76.07%** të buxhetit total.
- **Arsimi i Mesëm** (i përgjithshëm), fondet e rishikuara buxhetore **854.637** (Tetëqindë e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqindë e tridhjetë e shtatë) 000/lekë ose **22.78 %** të buxhetit total.

Për periudhën Janar-Prill 2021 janë planifikuar për tu shpenzuar **3.750.736** (Tremilion e shtatëqindë e **3.621.955** Tremilion e gjashtëqindëe njëzetë e një mijë e nëntëqindë e pesëdhjetë e pesë) lekë, e shprehur në përqindje **96.56 %** e buxhetit total për 4-mujorin e parë të vitit 2021.

Driferenca e mosrealizimit të periudhës me **3.43 %** apo 128.781 në 000/ lekë vjen për arsyt e mëposhtëme:

- DRAP Durrës dhe 12 ZVA-et në juridiksion të saj ka parashikuar fondet për **150** punonjës (137+13 sanitare) sipas strukturës organike të miratuar për punonjës në Administratë me ndryshimet gjatë vitit 2021 , **8.754** punonjës mësimor në Arsimin Bazë me ndryshimet gjatë vitit 2021 dhe **2.491** punonjës mësimor në Arsimin e Mesëm të Përgjithshëm me ndryshimet gjatë vitit 2020, pra ne total planifikuar 11.395 punonjës, por numri i punonjësve faktikë për periudhë buxhetore ka qenë i paplotësuar përgjatë vitit 2021.Sqarojmë se një pjesë e numrit te organikave për programin arsimin bazë dhe për arsimin e mesëm numër shtesë ky gjatë vitit 2021 i bërë për shërbimin psiko-social i cili pasi procedurave të konkurimit dhe emerimet e tyre u mbyllën në muajin dhjetor 2020 muaj që raportohet në vitin 2021.

Në lekë fondi i papërdorur për artikullin 600+601 në total për 3 programet është 88.534 000/lekë ose 1.02 % të fondit të planifikuar .

- Për arsye të vetë volumit të punës për realizimin nga ana e DRAP Durres të prokurimeve për 12 ZVAP-et në juridiksion lidhur me afatet për prokurim bazuar në Legjislacionin në fuqi ,fondet në artikullin 602 i papërdorur në total për 3 programet është 33.084 në 000/lekë ose 39 % të fondit të planifikuar

1.5 –Parashikimi I fondeve dhe alokimi i tyre për vitin 2021

Artikulli	Përshkrimi	Buxheti i vitit 2021	Plani 12-mujor 2021
			Në (000) Lekë
600	Paga personeli	9,081,077	8,566,863
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,449,998	1,411,176
602	Mallra dhe sherbime te tjera	343,601	258,035
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	307,207	4,850
	Shpenzime korrente	11,181,884	10,240,924
230	Aktive afatgjata jomateriale	0	
231	Aktive afatgjata materiale	83,360	8,900
	Shpenzime kapitale	83360	8900
	TOTALI	11,265,244	10,249,824



1.6- Informacion shpenzimet jashtë buxhetit për vitin 2021

ZVAP Kamëz ka raportuar që ka fonde jashtë buxhetit me shumën 26.000. lekë sponsorizim të trashëguar nga viti 2020

1.7- Relacion mbi fëmijët me aftësi të kufizuar

DRAP Durrës për 12 ZVAP-et në juridiksion ka gjithsej 1.780 fëmi me AK

1.8-Relacion për mësuesit ndihmës

Mësues ndihmës në DRAP Durrës për 12 ZVAP-et në juridiksion janë gjithsej 309 mësues

1.9 – Në DRAP Durrës Punonjësve Psiko-Social, të emëruar që punojnë në Institucionet arsimore për 12 ZVAP-et në juridiksion të DRAP Durrës janë 295 gjithsej.

2.0- Relacion për Oficerët e Sigurisë

Nisma "Shkolla të sigurta – Oficerët e Sigurisë në shkolla" është një iniciativë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (MASR) dhe Ministria e Brendshme, e cila i jep një vëmendje të posaçme rritjes së sigurisë, si brenda ashtu dhe përreth institucioneve arsimore. Qëllimi i kësaj nisme të përbashkët është garantimi i një mjedisi të nxëni të sigurt për nxënësit, stafin dhe komunitetin e shkollës.

DRAP Durrës për 12 ZVAP-et në juridiksion ka gjithsej 61 Oficerë Sigurie.

2.1-Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura të akumuluar dhe krijuara rishtazi për vitin 2021

Detyrimet e prapambetura

(1) Kodi i	(2) Emri i Institucionit	(3) Kodi	(4) Emri i Furnitorit/ Kreditorit	(5) Shuma e Detyrimit	(6) Detajet e fatures /	
					Data origjinale e	Shuma lekë
1011035	ZVAP TIRANE	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	4,208,320		4,208,320
1011035	ZVAP TIRANE	6027400	Sh.permb" Elite bailiff,S Offise"	295,486		295,486
1011035	ZVAP TIRANE	6027400	Zpermb" Dorian Skëndi"	65,000		65,000
1011007	ZVAP DURRES	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	559,874	31/03/2021	559,874
1011007	ZVAP DURRES	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	3,867,014	31/03/2021	3,867,014
1011130	ZVAP KAVAJË	6027400	Izet Laçi	639,666	23.10.2020	639,666
1011130	ZVAP KAVAJË	6027400	Semiha Gravardari	873,904	11.11.2019	873,904
1011130	ZVAP KAVAJË	6027400	Afërdita Kaja	689,740	20.10.2020	689,740
1011251	ZVA Shijak	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	1,532,284	Transporti Dhjetor	1,532,284
1011251	ZVA Shijak	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	509,855	Transporti Dhjetor	509,855
1011251	ZVA Shijak	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	964,230	Transport Janar	964,230
1011251	ZVA Shijak	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	21,615	Transporti Janar	21,615
1011092	ZVAP MAT	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	1,267,442		1,267,442
1011092	ZVAP MAT	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	71,167		71,167
1011249	ZVAP KLOS	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	1,759,861		1,759,861
1011249	ZVAP KLOS	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	66,510		66,510
1011006	ZVAP DIBER	6027400	Adriatik Xholi me permbarues Anisa	154,450	urdheri.nr 7331 date	154,450
1011090	ZVAP BULQIZE	6027400	Permbarues gjyqsor Privat " Gazmor Guri"	734,000	18.08.2020	734,000
1011090	ZVAP BULQIZE	6027400	ELITE BAILIFS OFFICE SHPK per	1,366,000	23.12.2020	1,366,000
1011090	ZVAP BULOIZE	6023900	Fililal I postes+ Llogarite personale e	1.193.000	31.03.2021	1.193.000

2.2- RELACION PËR ÇDO PROGRAM MBI REALIZIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE

Për të realizuar qëllimin dhe detyrat funksionale DRAP Durrës dhe 12 ZVA-et në juridiksion të saj ka përcaktuar disa objektiva për çdo program buxhetor si më poshtë:


2.3 -Programi 01110 – Panifikim Menaxhim Administrim

Objektivat e përcaktuara për programin “ *Planifikim Menaxhim Administrim* ” janë:

- **Objektivi 1.** Kryerja e pagesave të pagave dhe sigurimeve brenda afateve ligjore dhe në zbatim të plotë të ligjit.
- **Objektivi 2.** Përdorimi i drejtë i fondeve për shpenzime operative bazuar në legjislacionin në fuqi.
- **Objektivi 3.** Dhënia e shpërblimeve dhe ndihmës financiare nga fondi i veçantë për punonjës që dalin në pension dhe raste fatkeqësish, si dhe pagesat e dietave të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës si dhe cdo lloj pagese tjetër të bazuar në ligj.

2.4- Realizimi i fondeve buxhetore për programin “ *Planifikim Menaxhim Administrim* ” sipas llogarive ekonomike dhe arritja e objektivave për 4-mujorin e parë 2021.

	Artikulli	Përshkrimi	Buxheti i vitit 2021	Plani vjetor 2021		Fakti 4-mujor		
				Në (000) Lekë	Në (%) ndaj buxhetit 4-mujor	Në (000) Lekë	Në (%) ndaj planit 4-mujor	Në (%) ndaj buxhetit 4-mujori
11	600	Paga personeli	122,528	89,910	76%	32,334	80%	35.96%
11	601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	19,331	14,206	12%	5,373	13%	27.79%
11	602	Mallra dhe sherbime te tjera	25,635	13,781	12%	2,783	7%	10.85%
11	606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	380	80	0%	80	0%	11%
11	231	Investime	58,850	0	0	0	0	0
		TOTALI	226,724	117,977	100%	40,569	100%	100%



- **Artikulli 600+601** – DRAP Durrës dhe 12 ZVA-et në juridiksion të saj, shumën e shpenzuar për *“Paga dhe sigurime personeli”* është **37.706 në 000/lekë** nga **39.600 në 000/lekë** që ishin planifikuar, shpenzimet janë realizuar në masën **95.21 %**, për shkak se parashikimi i buxhetit është bërë për 150 punonjës sipas organikës, ndërsa në fakt kanë ushtruar aktivitetin e tyre me punonjës më pak, pra me organikë të paplotësuar.
Deklarimet në sistemin e tatimeve E-TAX për punësimet/largimet e punonjësve, si dhe deklaratimet e sigurimeve janë kryer brenda afateve ligjore. Pagat dhe sigurimet e punonjësve janë likuiduar deri më datë 10 të cdo muaji, kjo pasi ka ZVAP-e me numër të lartë punonjësish mësimor.
- **Artikulli 602** - Shuma e shpenzuar për *“Mallra dhe shërbime të tjera”* është **2.783 në 000/lekë** nga **3.085 në 000/lekë** që ishin parashikuar, ose **90.21 %** e limitit 4-mujor. Kjo llogari përbëhet nga shpenzimet operative për krijimin e kushteve të administratës për të ushtruar detyrat, si furnizimi me energji elektrike, ujë të pijshëm, kancelari, etj. Për arsye të vetë volumit të punës për realizimin nga ana e DRAP Durrës të prokurimeve për 12 ZVAP-et në juridiksion lidhur me afatet për prokurim bazuar në Legjislacionin në fuqi, fondet në artikullin 602 i përdorur në total për 3 programet .
- **Artikulli 606** – Shuma e shpenzuar për *“Transferta per buxhetet familiare dhe individet”* përket pagesave të punonjësve që përfitojnë nga fondi i veçantë për dalje në pension, raste fatkeqsish, apo sëmundje të rëndë gjatë periudhës Janar-Prill 2021, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ardhur nga ZVAP-et janë dërguar kërkesat për miratim në MASR.


2.5 -Programi 09120 – Arsimit Bazë

Objektivat e përcaktuara për programin *“Arsimit Bazë”* janë:

- **Objektivi 1.** Kryerja e pagesave të pagave dhe sigurimeve brenda afateve ligjore dhe në zbatim të plotë të ligjit.
- **Objektivi 2.** Realizimi në kohë dhe me efektivitet i transfertave të fondit të veçantë për shpërblimet për punonjës që dalin në pension, ndihmës financiare për raste fatkeqsish
- **Objektivi 3.** Shpenzimi i drejtë dhe me ekonomi i fondeve për shpenzime operative për vazhdimësinë e procesit mësimor.
- **Objektivi 4.** Ofrimi në kohë dhe mbulimi i shpenzimeve të shërbimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit e Arsimit Bazë që përfitojnë në bazë të ligjit.
- **Objektivi 5.** Sigurimi i vazhdimësinë së procesit mësimor dhe rritja e cilësisë.
- **Objektivi 6.** Rehabilitimi/ndërtimi i shkollave sipas standardeve.
- **Objektivi 7.** Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimi i mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e AB.
- **Objektivi 8.** Shtrirja e shërbimit të punonjësve social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara.

2.6-Realizimi i fondeve buxhetore për programin “Arsimi Bazë” sipas llogarive ekonomike dhe arritja e objektivave për 4-mujori I parë për vitin 2021.

	Artikulli	Përshkrimi	Buxheti i vitit 2021	Plani vjetor	Fakti 4-mujor
				Në (000) Lekë	Në (000) Lekë
11	600	Paga personeli	6,833,273	6,405,342	2,305,054
11	601	Sigurime shoqërore dhe shendetesore	1,091,577	1,044,444	395,077
11	602	Mallra dhe sherbime te tjera	274,433	191,553	42,616
11	606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	270,941	3,746	1,690
	231	Investime	20,510	4,600	0



- **Artikulli 600+601** – Shuma e shpenzuar për **“Paga dhe sigurime personeli”** është **2.700.083 në 000/lekë** nga **2.783.262** në 000/lekë të planifikuara për periudhën Janar-Prill 2021, shpenzimet për këto zëra janë realizuar në masën 97.01 % ,këtu ka ndikim të konsiderueshëm në mosrealizimin e fondit për paga e sigurime shoqërore si rezultat i mosplotësimit të organikave .

Deklarimet në sistemin e tatimeve E-TAX për punësimet/largimet e punonjësve, si dhe deklaratimet e sigurimeve janë kryer brenda afateve ligjore. Pagat dhe sigurimet e punonjësve janë likuiduar deri më datë 10 të cdo muaji,kjo pasi ka ZVAP-e me numër të lartë punonjësish mësimor.

- **Artikulli 602** - Shuma e shpenzuar për **“Mallra dhe sherbime te tjera”** është **42.616 në 000/ lekë** nga **227.527.896** lekë të planifikuara për 4-mujorin e parë të vitit 2021, janë alokuar fonde vetëm për mbulimin e shpenzimeve të transportit për mësuesit që udhëtojnë mbi 5 km dhe nxënësve mbi 2 km nga qendra e banimit. Mjaft zyra kanë pa likuiduar shpenzime transporti pasi vetë procedura e prokurimit në zërin shpenzime transport nuk është realizuar akoma bazuar në mjaft problematika të dala në zbatim të ligjit. DRAP Durrës dhe ZVAP-t në varësi gjatë viti 2021 janë gjendur përball paqartësive lidhur me procedurën e prokurimit të transportit për vitin 2021.

Për vitin 2020 me shkresën nr. Nr.71/3 Prot, dt.04.02.2020 të Ministrise së Arsimit Sportit dhe Rinisë " Për prokurimin e fondeve publike për transportin e punonjesve arsimore dhe nënësve që mësojnë jashtë vendbanimit për vitin 2020" MASR ngarkoj DRAP-et për zhvillimin e transportit për atë vit. DRAP Durrës ka kërkuar me shkresën nr.1944 prot, datë 26.11.2020 “Kërkesë” drejtuar MASR ka sqaruar të gjitha arsyet e mosrealizimit të prokurimit për vitin 2020 konkretisht: “Kërkojmë nga ana juaj që prokurimi I transportit për vitin 2021 e në vazhdim të realizohet nga ZVAP-t në përputhje me VKM 682 I ndryshuar.” Në pikën 2 dhe 3 tëVKM nr.682 i ndryshuar përcaktohen baza mbi të cilën zhvillohet prokurimi: mbi bazen e hartave linjave të transporti publik të licensuara nga pushteti vendor dhe qëndror.

Nga dokumentacioni I vënë DRAP në dispozicion nga disa ZVAP rezulton si më poshtë:

Linjat e transportit publik të licensuara nuk përfshijnë të gjitha linjat e transportit të nxënësve dhe mësuesve të miratuara nga ZVAP-t pranë njësive të pushtetit vendor.

Nga sa më sipër është kërkuar ndërhyrje për rregullimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar, pasi në këto kushte është e pamundur zhvillimi i procedurave të prokurimit. Gjithashtu sqarojmë se për shkak të këtyre pengesave nga pjesa më e madhe e ZVAP_ve nuk është realizuar pagesë transport për vitin 2021

- **Artikulli 606** - Shuma e shpenzuar për “*Transferta per buxhetet familiare dhe individet*” është **1.690 në 000/lekë nga 3.746 ne 000/lekë** fond i vecantë për dalje në pension ,semundje të rëndë apo raste fatkeqësie gjatë periudhës Janar-Prill 2021, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ardhur nga ZVAP-et janë dërguar kërkesat për miratim në MASR.
- **Artikulli 231** –Investime Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit bazë prokurim I cili është planifikuar për muajin Maj 2021

2.7-Programi 09230– Arsimi i Mesëm (i përgjithshëm)

Programi synon krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit për një arsim cilësor, e bashkëkohor; mirë menaxhim të burimeve njerëzore; fuqizimin dhe rritjen e autonomisë shkollore; shtrirjen dhe zgjerimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm; për rritjen e nivelit të arsimit të popullsisë, për ta përafuar atë me standardet evropiane dhe për të përgatitur qytetarë më të aftë për një shoqëri demokratike. Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qëndrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Hartimi dhe zbatimi i kurrikules së re në arsimin e mesëm. e zhvillimit profesional të mësuesve. Promovimi dhe zgjerimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në edukim. Zgjerimi i kapaciteteve infrastrukturore në institucionet shkollore të arsimit të mesëm.


Qëllimi i politikës; “Krijimi i mundësive për çdo nxënësi që përfundon arsimin bazë të regjistrohesh në arsimin e mesëm të lartë në masën në masën 98-99% në fund të vitit 2022, përfshirë dhe arsimin profesional. Zbatimi i kurrikulës së re (me kompetenca). Rritja e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet trajnimit të përvitshëm të mësuesve, drejtuesve Institucioneve Arsimore(IA) dhe drejtuesve të rrjeteve profesionale si dhe zhvillimit profesional të tyre, sipas sistemit të ri për zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Realizimi çdo vit i Maturës Shtetërore dhe portalit “Mësues për Shqipërinë”. Përmirësimi i standardeve infrastrukturore” .

Objektivat kryesore:

- **Objektiv 1.** Nxënësi që regjistrohesh dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë të arrijë në 95-97%e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë.
- **Objektiv 2.** Zbatimi i kurrikules së re dhe trajnimi i mësuesve në gjimnaze dhe shkollat social-kulturore, si dhe zbatimi i sistemit të ri të zhvillimit profesional.
- **Objektiv 3.** Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në arsimin e mesëm shkollat
- **Objektivi 4.** Shpenzimi i drejtë dhe me ekonomi i fondeve për shpenzime operative për vazhdimësinë e procesit mësimor.
- **Objektivi 5.** Ofrimi në kohë dhe mbulimi i shpenzimeve të shërbimit të transportit për mësuesit e Arsimit të Mesëm që përfitojnë në bazë të ligjit.
- **Objektivi 6.** Sigurimi i vazhdimësinë së procesit mësimor dhe rritja e cilësisë.
- **Objektivi 7.** Realizimi në kohë dhe me efektivitet i transfertave të fondit të veçantë për shpërblimet për punonjës që dalin në pension, ndihmës financiare për raste fatkeqësish
- **Objektivi 8.** Kryerja e pagesave të pagave dhe sigurimeve brenda fafateve ligjore dhe në zbatim të plotë të ligjit.

2.8-Realizimi i fondeve buxhetore për programin “Arsimi i Mesëm” sipas llogarive ekonomike dhe arritja e objektivave për 4-mujorin e parë të vitit 2021.

	Artikulli	Përshkrimi	Buxheti i vitit 2021	Plani vjetor		Fakti 4-mujor		
				Në (000) Lekë	Në (%) ndaj buxhetit 4-mujor	Në (000) Lekë	Në (%) ndaj planit 4-mujor	Në (%) ndaj buxhetit 4 mujori
11	600	Paga personeli	2,125,276	2,071,585	83%	708,766	85%	34.21%
11	601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	339,090	352,526	14%	121,810	15%	35.92%
11	602	Mallra dhe sherbime te tjera	43,533	53,751	2%	6,029	1%	13.85%
11	606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	35,886	4,300	0%	393	0%	14%
11	231	Investime	4,000	0				
		TOTALI	2,547,785	2,482,162	100%	836,996	100%	100%



- **Artikulli 600+601** – Shuma e shpenzuar për “*Paga dhe sigurime personeli*” është **830.575 në 000/lekë** lekë nga **834.037 në 000/ lekë** që ishin planifikuar për 4-mujorin e parë të vitit 2021, shpenzimet për këto zëra janë realizuar në masën 99.58 %. Këtu ka ndikim të konsiderueshëm në mosrealizimin e fondit për paga e sigurime shoqërore si rezultat i mosplotësimit të organikës me punonjës mësimor.

Deklarimet në sistemin e tatimeve E-TAX për punësimet/largimet e punonjësve, si dhe deklarimet e sigurimeve janë kryer brenda afateve ligjore. Pagat dhe sigurimet e punonjësve janë likuiduar deri më datë 10 të cdo muaji, kjo pasi ka ZVAP-e me numër të lartë punonjësish mësimor.

- **Artikulli 602** Shuma e shpenzuar për “*Mallra dhe sherbime te tjera*” është **6.029 në 000/ lekë** nga **17.576 në 000/ lekë** të planifikuara për periudhën Janar-Prill 2021.

Shpenzime për transportin për 18.885 nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla dhe mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë me afro 212.489.685 lekë nga 230.460.444 leke të planifikuara si 4 mujor 2021.

VKM NR. 398, DATË 3.5.2017 Për disa ndryshime në vendimin nr.682, datë 29.7.2015, të këshillit të ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar

1. Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e:

a) Punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator), të institucioneve arsimore publike, që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në largësinë mbi 5 km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim;”.

b) nxënësve që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg institucioneve arsimore publike më të afërta (shkollë/kopsht); Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë institucionet arsimore publike (shkollë/kopsht).

c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në institucionet arsimore publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);

ç) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik

- Mjaft zyra kanë pa likujduar shpenzime transporti pasi vetë procedura e prokurimit në zërin shpenzime transport nuk është realizuar akoma bazuar në mjaft problematika të dala në zbatim të ligjit. DRAP Durrës dhe ZVAP-t në varësi gjatë viti 2021 janë gjendur përball paqartësive lidhur me procedurën e prokurimit të transportit për vitin 2021.

Për vitin 2020 me shkresën nr. Nr.71/3 Prot, dt.04.02.2020 të Ministrise së Arsimit Sportit dhe Rinisë " Për prokurimin e fondeve publike për transportin e punonjesve arsimore dhe nënësve që mësojnë jashtë vendbanimit për vitin 2020" MASR ngarkoj DRAP-et për zhvillimin e transportit për atë vit. DRAP Durrës ka kërkuar me shkresën nr.1944 prot, datë 26.11.2020 “Kërkesë” drejtuar MASR ka sqaruar të gjitha arsyet e mosrealizimit të prokurimit për vitin 2020 konkretisht: “Kërkojmë nga ana juaj që prokurimi I transportit për vitin 2021 e në vazhdim të realizohet nga ZVAP-t në përputhje me VKM 682 I ndryshuar.” Në pikën 2 dhe 3 tëVKM nr.682 i ndryshuar përcaktohen baza mbi të cilën zhvillohet prokurimi: mbi bazen e hartave linjave të transporti publik të licensuara nga pushteti vendor dhe qëndror.

Nga dokumentacioni I vënë DRAP në dispozicion nga disa ZVAP rezulton si më poshtë:


Linjat e transportit publik të licensuara nuk përfshijnë të gjitha linjat e transportit të nxënësve dhe mësuesve të miratuara nga ZVAP-t pranë njësive të pushtetit vendor.

Nga sa më sipër është kërkuar ndërhyrje për rregullimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për transportin rrugor të nxënësve të arsimit parashkollor, parauniversitar, pasi në këto kushte është e pamundur zhvillimi i procedurave të prokurimit. Gjithashtu sqarojmë se për shkak të këtyre pengesave nga pjesa më e madhe e ZVAP_ve nuk është realizuar pagesë transport për vitin 2021

- **Artikulli 606** - Shuma e shpenzuar për “*Transferta per buxhetet familiare dhe individet*” është **36.247.565 lekë** për subvecion te teksteve shkollore dhe 3.559.911 lekë fondin e vecantë për dalje në pension ,semundje të rëndë apo raste fatkeqësie gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ardhur nga ZVAP-et janë dërguar kërkesat për miratim në MASR, pas miratimit është proceduar me likuidimin ne llogaritë bankare të përfitueve.
- **Artikulli 231** –Investime Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit e mesëm prokurim I cili është planifikuar për muajin Maj 2021


2.9-Numri I nxënësve dhe mësuesve që kanë përfituar shpenzime transporti për vitin 2020 në Arsimin Bazë

DRAP Durrës	Numri I nxënësve dhe mësuesve që kanë përfituar shpenzime transporti për vitin 2020 në Arsimin Bazë
ZVAP Dibër	1,971
ZVAP Klos	1,111
ZVAP Vorë	970
ZVAP Kamëz	370
ZVAP Shijak	741
ZVAP Krujë	2,255
ZVAP Bulqizë	813
ZVAP Tiranë	2,609
ZVAP Rrogozhinë	449
ZVAP Kavajë	726
ZVAP Durrës	4,598
ZVAP Mat	885
T O T A L I	17,498




3.0-Fondi i përdorur në Arsimin Bazë për vitin 2021 nga 12 ZVAP-et në juridiksion të DRAP Durrës për shpenzime transporti.

DRAP Durrës	Fondi i përdorur në Arsimin Bazë për vitin 2020
ZVAP Dibër	3,185,788
ZVAP Klos	3,535,380
ZVAP Vorë	2,565,728
ZVAP Kamëz	2,834,013
ZVAP Shijak	2,504,560
ZVAP Krujë	6,839,076
ZVAP Bulqizë	2,743,000
ZVAP Tiranë	2,897,353
ZVAP Rrogozhinë	1,577,970
ZVAP Kavajë	0
ZVAP Durrës	10,472,360
ZVAP Mat	3,461,000
T O T A L I	42,616,228




3.1-Numri I nxënësve dhe mësuesve që kanë përfituar shpenzime transporti për vitin 2021 në Arsimin e Mesëm për 12 ZVAP-et në juridiksion të DRAP Durrës

	Numri I nxënësve dhe mësuesve që kanë përfituar shpenzime transporti për vitin 2021 në Arsimin e Mesëm
ZVAP Dibër	30
ZVAP Klos	94
ZVAP Vorë	67
ZVAP Shijak	306
ZVAP Krujë	185
ZVAP Rrogozhinë	6
ZVAP Kavajë	7
ZVAP Durrës	671
ZVAP Mat	21
	1,387



3.2-Fondi i përdorur në Arsimin e Mesëm për vitin 2021 për shpenzime transporti për 12 ZVAP-et në juridiksion të DRAP Durrës


	Fondi i përdorur në Arsimin e Mesëm për vitin 2021
ZVAP Dibër	2,399,630
ZVAP Klos	868,822
ZVAP Vorë	418,203
ZVAP Shijak	1,012,589
ZVAP Krujë	1,592,130
ZVAP Rrogozhinë	89,464
ZVAP Kavajë	82,218
ZVAP Durrës	3,947,439
ZVAP Mat	525,220



3.3- Numri I punonjësve të Administratës bashkë me numrin e miratu

Numri I punonjësve të Arsimit të Mesëm për 12 ZVAP-e në juridiksion të DRAP Durrës			
	Numri I punonjësve të planifikuar për vitin 2021	Numri I punonjësve faktik për vitin 2021	Sanitaret
ZVAP Rrogozhinë	6	4	1
ZVAP Kavajë	8	8	1
ZVAP Durrës	15	15	1
ZVAP Mat	6	6	1
ZVAP Tiranë	35	35	1
ZVAP Bulqizë	6	4	1
ZVAP Krujë	8	7	1
ZVAP Shijak	6	6	1
ZVAP Kamëz	11	11	1
ZVAP Vorë	6	6	1
ZVAP Klos	6	5	1
ZVAP Dibër	9	8	1
DRAP Durrës	15	15	1
TOTALI	137	130	13


Numri i punonjësve të Administratës për DRAP +12 ZVAP-et në juridiksion të DRAP Durrës



3.4- Numri I punonjësve të Arsimit Bazë për 12 ZVAP-e në juridiksion të DRAP Durrës


Numri I punonjësve te administrates DRAP+12 ZVAP-e ne juridiksion		
	Numri i punonjësve të planifikuar Arsimi Bazë për vitin 2021	Numri I punonjësve faktik për vitin 2021
ZVAP Rrogozhinë	240	234
ZVAP Kavajë	367	366
ZVAP Durrës	1267	1267
ZVAP Mat	276	260
ZVAP Tiranë	3658	3658
ZVAP Bulqizë	326	318
ZVAP Krujë	527	527
ZVAP Shijak	198	186
ZVAP Kamëz	779	779
ZVAP Vorë	251	248
ZVAP Klos	189	182
ZVAP Dibër	676	670

Numri i punonjësve të Arsimit Bazë për DRAP +12 ZVAP-et në juridiksion të DRAP Durrës



3.5- Numri I punonjësve të Arsimit të Mesëm për 12 ZVAP-e në juridiksion të DRAP Durrës

Numri I punonjësve të Arsimit të Mesëm për 12 ZVAP-e në juridiksion të DRAP Durrës			
		Numri I punonjësve të planifikuar Arsimi Mesëm për vitin 2020	Numri I punonjësve të paguar faktikisht në dhjetor 2020
ZVAP RROGOZHINE	09230	35	35
ZVAP KAVAJË	09230	75	75
ZVAP Durrës	09230	332	332
ZVAP MAT	09230	81	75
ZVAP Tirane	09230	1302	1302
ZVAP BULQIZË	09230	69	63
ZVAP KRUIJE	09230	114	114
ZVAP Shijak	09230	32	32
ZVAP Kamez	09230	204	204
ZVAP VORE	09230	64	61
ZVAP KLOS	09230	48	45
ZVAP DIBER	09230	135	135



3.6- Punësime nga portali ose jashtë portalit për periudhën Janar-Prill 2021 për 12 ZVAP-et në juridiksion të DRAP Durrës.

ZVAP/DRAP	Punësime vende vakante definitive nga portali	Punësime vende vakante provizore nga portali	Punësime me kandidatë jashtë portalit	Gjithsej punësime
Zyra Vendore Arsimore Bulqize	0	0	0	0
Zyra Vendore Arsimore Mat	0	1	1	2
Zyra Vendore Arsimore Klos	0	2	44	46
Zyra Vendore Arsimore Shijak	1	9	0	10
Zyra Vendore Arsimore Kavaje	8	20	9	37
Zyra Vendore Arsimore Vore	0	12	8	19
Zyra Vendore Arsimore Rrogozhine	8	21	7	36
Zyra Vendore Arsimore Diber	12	42	51	104
Zyra Vendore Arsimore Kruje	7	7	12	26
Zyra Vendore Arsimore Kamez	4	7	17	28
Zyra Vendore Arsimore Durrës	5	32	12	48
Zyra Vendore Arsimore Tirane	12	68	33	113

3.7- Kurrikula

Funksionimi dhe mbarëvajtja e IPAP-ve në varësi është përgjegjësi e DRAP dhe ZVAP. Përgjegjësia e institucionit tonë në bashkëpunim me Zyrat Vendore është të sigurohet zbatimi i kurrikulës, metodologjisë dhe standardeve, të vlerësohen nevojat dhe problematikat, të propozohen zgjidhje, të monitorohet kualifikimi i personelit mësimor për kurrikulën, të garantohet ngritja e rrjeteve profesionale, rekrutimi i mësuesve sipas kritereve të përcaktuara.

- **Një nga sfidat e implementimit të kësaj kurrikule siç parashikohet edhe në Strategjinë Kombëtare**, vazhdon të mbetet sigurimi i infrastrukturës që ofron mundësi në përdorimin dhe përmbajtjen digjitale të procesit mësimor. Për këtë është treguar kujdes në aftësimin e personelit mësimor në përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie duke ofruar trajnime të vazhdueshme. Për më tepër që situata e krijuar nga pandemia COVID-19 e ka bërë këtë sfidë prioritare në të gjithë institucionet kaskadë, që nga MASR dhe deri tek Institucioni Arsimor. Unifikimi i platformave të mësimin online, pajisja me infrastrukturë hardëare tablet, PC, mësimet në RTSH etj. janë disa nga masat e marra në përmbushje të realizimit të objektivave dhe treguesve matës që institucionet arsimore kanë për të konkuruar mes tyre me anë të Kartës së Performancës.
- **Ndjekja e procesit të organizimit të Fazës së Dytë të Olimpiadave Kombëtare për vitin 2020-2021. Miratimi i komisioneve të administrimit dhe vlerësimit të testit.**
 - a. Janë zhvilluar olimpiadat në të gjitha lëndët ku kemi fituesit sipas tabelës së mëposhtme:

Fitues Faza II Olimpiada Kombëtare

Nr	ZVAP	Matematikë 9	Matematikë AML	Fizikë	Kimi	Biologji	Informatikë	Gjuhë dhe Letërsi	Histori	Gjeografi
1	Bulqizë	0	0	0	0	0	0	2	0	0
2	Dibër	0	0	0	1	0	0	23	0	3
3	Durrës	1	11	18	8	10	8	9	0	0
4	Kamëz	0	3	0	5	2	0	5	0	0
5	Kavajë	0	0	0	0	0	0	1	0	0
6	Klos	0	0	0	0	0	0	2	0	0
7	Krujë	0	0	0	0	0	0	3	0	0
8	Mat	1	0	2	0	0	0	5	0	0
9	Rrogozhinë	0	0	0	0	0	0	7	0	0
10	Shijak	0	0	0	0	0	0	76	3	5
11	Tiranë	1	6	3	25	27	10	2	0	0
12	Vorë	0	0	0	0	0	0	109	5	10
	TOTAL	3	20	23	39	39	18	244	8	18

- **Monitorim i ZVAP-ve në zbatimin e udhëzimeve MASR-së dhe rregullores për organizimin e olimpiadave në ZVAP-të. Me prioritet kanë qenë ZVAP-të me numër më të madh nxënësish pjesëmarrës si:**

- a. Tiranë
- b. Durrës
- c. Kavajë
- d. Vorë
- e. Kamëz

➤ **Kualifikimi i mësuesve 2021**

Pjesëmarrja e mësuesve Zhvillimi profesional i mësuesve është një nga detyrat themelore të punës për DRAP Durrës, por gjatë këtij viti, për shkak të kushteve të krijuara është punuar vetëm në identifikimin e nevojave. Në vijim, është organizuar puna për realizimin e procesit të kualifikimit të mësuesve për vitin 2020, duke u ngritur grupet e punës dhe duke u orientuar të gjitha ZVAP për të vlerësuar me korrektësi portofolin personal dhe profesional të mësuesve. Kualifikimi i mësuesve për vitin 2021 u mbështet në Udhëzimin udhëzimit nr.4 datë 26.02.2021 “ Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve.

Për sa më sipër:

- Monitoruam me urdhër dhe platformë monitorimi ZVAP Tiranë, Kamëz. Nga kontrolli i dosjeve me kampionim në secilën prej zyrave rezulton se janë zbatuar përcaktimet sipas udhëzimit përkatës. Janë konstatuar disa gabime në pjesën e përfitimit të bonuseve gjuhë e huaj dhe master passhollimi për të cilat në bashkëpunim me institucionet përkatëse eprore dhe të varësisë janë marrë masa që të korrigojnë në kohë gabimet e konstatuara.
- Numri i mësuesve të DRAP Durrës që morën pjesë në kualifikim është 1383 kandidatë.

Me fokus monitorimin e cilësisë dhe për të fuqizuar procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, në mënyrë që proceset vlerësuese të jenë të suksesshme dhe konform standardeve janë realizuar trajnime në bashkëpunim me QSHA dhe ASCAP për programet dhe testet e Maturës Shtetërore me mësuesit e lëndëve gjuhë shqipe, matematikë, TIK.

➤ **Matura shtetërore 2021**

- 1- Në zbatim të Urdhrit Nr.364, dt.24.12.2020, të MASR - "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë" janë përcaktuar në bashkëpunim me ZVAP-të dhe DPAP-në qendrat e zhvillimit të provimit të Maturës Shtetërore, ku me vendim të KOMSH është përcaktuar që sipas skenarit 3 shkollat me më pak dhe deri në 70 nxënës grupohen në 1 qendër. Natyrisht provimi do të zhvillohet në zbatim të masave anti COVID-19.
- 2- Përcaktimi i përfaqësuesve të MASR në provimet e Maturës Shtetërore.

➤ **Provimet VANAF**

- Udhëzimit Nr. 6, datë 31.3. 2021 “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, viti shkollor 2020-2021”; Urdhërit Nr. 78, datë 27.02.2020, “Për miratimin e rregullores për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor”, Urdhërin Nr. 75, datë 18. 05. 2021 “Për monitorimin e procesit të zhvillimit të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor”, me datën 21.05.2021, u zhvillua testimi i nxënësve të klasave të pesta “Për zhvillimin e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor, viti shkollor 2020-2021”.

- Me autorizimin të drejtores së DRAP Durrës, përfaqësues të DRAP Durrës monitoruan procesin e hedhjes së shortit për shpërndarjen e PAP-ve, AP-ve dhe AS-ve në qendrat e provimeve, në ZVAP-të nën juridiksionin e DRAP Durrës, si dhe dhe procesin e zhvillimit të provimit në Qendrat e Provimit të përzgjedhura me kampinim.

- Nga raportimet e monitoruesve që DRAP Durrës ka autorizuar rezultojnë se janë 198 qndra provimi dhe 423 shkolla pjesëmarrëse. Nxënës të regjistruar për zhvillimin e provimit janë 14436 nxënës, të munguar 373 nxënës dhe pjesëmarrës janë 14063 nxënës. Të dhënat sipas tabelës së mëposhtme:

DRAP	Nr. i qendrave të provimit	Nr. i shkollave pjesëmarrëse	Nr. i nxënësve pjesëmarrës në provim për çdo qendër	Nr. i nxënësve të munguar për secilën qendër provimi	Problematika që dolën gjatë procesit
DURRËS	198	423	14436	373	Nu ka probleme

- 3- Procesi i përzgjedhjes së teksteve** është bërë në zbatim të urdhërit nr.46, datë 16.03.2021. Nga IAP-të dhe Zyrrat Vendore të Arsimit Parauniversitar është bërë plotësimi i formularit të përzgjedhjes duke u mbështetur në katalogun e teksteve shkollore. Sipas afateve dhe kërkesave procesi i përzgjedhjes së teksteve është përfunduar me sukses. Për këtë proces u monitoruan në bashkëpunim me ZVAP-të institucione arsimore si me poshtë:

Nr.	ZVAP	Numri i IA publike për monitorim				
		Gjithsej	9-vjeçare qytet	9-vjeçare fshat	Gjimnaze	SHMB
1.	Bulqizë	7	2	2	2	1
2.	Dibër	9	3	2	3	1
3.	Durrës	12	5	3	3	1
4.	Kamëz	8	4	2	2	0
5.	Kavajë	8	3	2	2	1
6.	Klos	5	2	1	1	1
7.	Krujë	9	3	3	2	1
8.	Mat	5	2	1	1	1
9.	Rrogozhinë	5	2	1	1	1
10.	Shijak	5	2	2	1	0
11.	Tiranë	22	9	4	6	3
12.	Vorë	5	1	2	1	1
	DRAP Durrës	100	38	25	25	12

- 4- Monitorim i zbatimit e udhëzimeve MASR-së dhe institucioneve të tjera bashkëpunuese nga të gjithë institucionet arsimore.**

- Vlerësimi i institucioneve arsimore për masat e marra për zbatimin e Urdhrit dhe rregullores së Olimpiadave Kombëtare 2020-2021.
- Janë ndjekur planet e veprimit për Strategjitë për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për fëmijët me AK, romë dhe egjiptian. Nismat çdo fëmijë në shkollë për të eliminuar braktisjen. Stop dhunës në shkolla. Antitrafikimi dhe bullizmi.
- Monitorimi i zbatimit të Urdhrit nr. 46, datë 16.03.2021 për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve “Për porositjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1-4 dhe 6-12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022”, dhe të Udhëzimit nr. 21, date 13.08.2020 “Për përcaktimin e procedurave për administrimin e teksteve shkollore në përdorim falas në arsimin parauniversitar”.
- Monitorim mbi plotësimin nga institucionet e arsimit parauniversitar të parapëlqimeve të nxënësve për kurrikulën me zgjedhje në ZVAP-të dhe IAP-të (Gjimnaze) në varësi të DRAP Durrës kjo në zbatim të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” me nr.4699/1 prot, datë, 30.04.2019

3.8 - Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në DRAP Durrës

Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në DRAP Durrës për vitin 2021, në zbatim të Ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 " Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar ", urdhërit nr.68, datë 05.04.2019, për "Miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar", "Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar" me nr.4699/1 prot, datë, 30.04.2019, ka kryer inspektime në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në juridiksion të saj.

Theksojmë se qëllimi i inspektimeve, të realizuara, ka qenë dhe është verifikimi i funksionimit të IA dhe ZVAP në raport me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe ndikim në cilësinë e menaxhimit të brendshëm të tyre.

Konkretishtë inspektimet me natyrë vlerësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në DRAP Durrës janë orientuar nga plani vjetor dhe ai gjashtë mujor, por dhe nga problematikat e diktuar nga portali i “ Bashkëqeverisjes me Qytetarët” Theksojmë se inspektimet me natyrë vlerësimi janë mbështetur në Manualin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të IA. SIVC ka monitoruar ZVAP Tiranë dhe ZVAP Kamëz me tematikë për masat e marra, për sigurimin e kushteve në çdo institucion arsimor, sipas udhëzimeve të MASR-së . Janë monitoruar me tematikë për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, në përputhje me “skenarin 2”, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar, janë monitoruar me qëllim vlerësimin e masave të marra nga shkolla për përzgjedhjen dhe porositjen e teksteve shkollore për vitin shkollor 2021-2022 në 8 IA :

Është synuar të vlerësohen treguesit që kanë të bëjnë me hartimin e dokumentave kryesor për funksionimin e IA; plani afatmesëm, plani vjetor i shkollës, rregullorja e brendshme, mënyra e monitorimit dhe dokumentimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës, bashkëpunimi i shkollës me aktorët dhe faktorët që janë përfitues të shërbimit arsimor, ose të interesuar për cilësinë e shërbimit të ofruar, si dhe shërbimi psiko-social.

Vlerësohet fakti se Sektori i Inspektimit ka dalë me përfundime, ka dhënë rekomandime dhe ka verifikuar zbatueshmërinë e tyre për IA, me synim përmirësimin e menaxhimit të brendshëm të shkollës.

Po kështu janë vlerësuar në kohë ankesat në portalin e “ Bashkëqeverisjes me Qytetarët”. Theksojmë se ankesat e trajtuara nga ky sektor kanë gjetur zgjidhje në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Drejtim i rëndësishëm i monitorimit dhe vlerësimit kanë qenë ZVAP në varësi. Është monitoruar zbatimi i Udhëzimit të MASR -së, nr.13, datë 22.05.2019 për: “ Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesve në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ” Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar.

Theksojmë se ankesat e qytetarëve për punësimet janë vlerësuar në kohë dhe kanë gjetur zgjidhje Duke ju falenderuar për bashkëpunimin:

DREJTORI DRAP

